



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2614/2 prot

Datë 23.11.2022

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Rroku GUEST*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. *REF-43645-09-28-2022*, me objekt “*Sistemim i rrugeve te brendshme Naraç*”, me fond limit 23.403.987 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 21.10.2022, nga autoriteti kontraktor Bashkia Vau Dejes.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS*” SHPK  
Adresa: *Rruga “Nazmi Kryeziu”, Ndërtesa 1/1, Hyrja 2, Ap. 8, Nr pasurie 1/532+3-9, Zona kadastrale 8592, Kodi postar 4001, Shkodër.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vau Dejes  
Adresa: *Rruga “Qafa e Gurit”, Vau Dejes.*

Në datën 23.11.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2614 prot, e operatorit ekonomik “*Rroku GUEST*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. *REF-43645-09-28-2022*, me objekt “*Sistemim i rrugeve te brendshme Naraç*”, me fond limit 23.403.987 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 21.10.2022, nga autoriteti kontraktor Bashkia Vau Dejes.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Rroku GUEST*” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon. a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbt kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Rroku GUEST” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr 2614/2022 protokolli, datë 23.11.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

*“Nuk keni paraqitur listepagesat dhe vertetim kontributesh”.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 23.11.2022.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**